

Në themel të kësaj qyteze është platforma që synon zhvillimin intelektual, social, emocional dhe fizik të fëmijëve e të rinjve.



World Vision është një organizatë zhvillimi komunitar, e krishterë, humanitare dhe advokatie. Prej dy dekadash ne punojmë me mbi 30 mijë fëmijë, në 220 komunitete në nevojë. World Vision e filloi veprimtarinë e vet më 1950-ën dhe vepron në thujtse 100 vende të botës.

Në Shqipëri, World Vision filloi të punonte në 1999-ën, si përgjigje ndaj krizës së refugjatëve kosovarë. Që prej atëherë është fokusuar tek zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët dhe të rinjtë më në nevojë.

World Vision është lider në transformimin e jetëve të fëmijëve dhe komuniteteve ku punon.

#### Vizioni Ynë

Vizioni ynë për çdo fëmijë, jeta në tërësinë e saj....  
...Lutja jonë për çdo zemër, dëshira për ta bërë atë realitet.



#### Adresa

Rruga: "Niko Kovaçi", Lagjia 10, pranë kompleksit sportiv "Skënderbeu", Korçë

#### Na kontaktoni:

E-mail: [qytezaefemijeve\\_korce@wvi.org](mailto:qytezaefemijeve_korce@wvi.org)  
Tel: 0689002003 / 0689002004 / 0689044839



Qendra e parë dhe e vetmja e përmasave të tilla në të gjithë rajonin që ka një gamë kaq të gjerë shërbimesh dhe një mision social, edukues dhe argëtues.

Kjo është qendra e parë dhe e vetme në vend që ofron një gamë kaq të gjerë shërbimesh.

...është një mundësi ku fëmijë dhe të rinj korçarë, por edhe të zonave të tjera përreth, mund të kalojnë kohën e lirë duke u argëtuar, duke krijuar miqësi të reja, por edhe duke zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre si pjesë e kurseve dhe programeve të larmishme që ofrohen...

## Pse është unike Qyteza e Fëmijëve në Korçë?

Është e para dhe e vetmja e përmasave të tilla në të gjithë rajonin që ka një mision social, edukues dhe argëtues.


Ndërthurja e ambientit miqësor, stafit profesionist dhe mjeteve didaktike do i bëjë fëmijët të ndihen të lirë të shprehin mendimet e tyre, të zgjerojnë njohuritë e të luajnë me njëri-tjetrin.

## Kujt i shërben?

Fëmijëve dhe të rinjve nga mosha 3 deri në 14 vjeç. Në bazë të studimeve shkencore, kjo grupmoshë dallohet për shpejtësinë dhe aftësinë e nxënies. Prandaj në themel të kësaj qyteze është platforma që synon zhvillimin intelektual, social, emocional dhe fizik të fëmijëve e të rinjve.

**Ndërthurja e ambientit miqësor, stafit profesionist dhe mjeteve didaktike do i bëjë fëmijët të ndihen të lirë të shprehin mendimet e tyre.**

## ZHVILLIMI INTELEKTUAL




- 1 Përforsim dhe avancim të njohurive shkollore
- 2 Praktika/përvoja që i fokusojnë drejt karrierës
- 3 Kurse, lojra, praktikë dhe angazhim intelektual



## ZHVILLIMI FIZIK

- 1 Zhvillim të shëndetshëm nëpërmjet sportit
- 2 Sporti si formë edukimi dhe zhvillimi i gjithanshëm
- 3 Sporte të ndryshme, lojra në natyrë

## ZHVILLIMI SOCIAL



- 1 Përforsim dhe avancim i aftësive sociale
- 2 Zhvillim i aftësive për të ndërvepruar me të tjerët dhe aspektet jetësore
- 3 Punë në skuadër, lojra/aktivitete ku fëmijët e të rinjtë mund të ndërveprojnë me njëri tjetrin



## ZHVILLIMI EMOCIONAL

- 1 Zhvillim psiko-emocional
- 2 Njohja e botës emocionale tek vetja dhe të tjerët
- 3 Metodologji shprehëse të ndjenjave, emocioneve dhe identitetit



# Çfarë aktivitetestesh ofrohen?

